

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Përmbajtja:

	Faqe
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018	2
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	4
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	5
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	6 – 16

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

Aktivitet	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
I. Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	4	4,308,882	8,955,283
Aktive financiare afatshkurtra	5	89,882,485	38,661,151
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	6	6,400,911	11,459,924
Parapagim tatim-fitimi	7	725,943	3,786,844
Total i aktiveve afatshkurtra (I)		101,318,161	62,863,202
II. Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	17,716,828	21,057,549
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,261,790	1,500,112
Totali i aktiveve afatgjata (II)		18,978,618	22,557,660
Totali i aktiveve (I + II)		120,296,779	85,420,863
Detyrimet dhe kapitali			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet	10	93,120,373	76,165,108
Dividentet e paguar	11	16,873,481	24,074,121
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		109,993,854	100,239,229
II. Detyrimet afatgjata			
Grantet dhe të ardhurat e shtyra	12	403,655	389,551
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		403,655	389,551
Totali i detyrimeve (I + II)		110,397,509	100,628,780
III. Kapitali			
Kapitali aksioner		100	100
Fitimi/(Humbja) e akumuluar		(15,208,018)	7,067,688
Fitimi i vitit		25,107,188	(22,275,706)
Totali i kapitalit (III)	1	9,899,270	(15,207,918)
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		120,296,779	85,420,862

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 u aprovuan nga PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë:

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

		31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shitjet neto	13	228,246,879	181,424,821
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	14	1,376,172	839,139
Totali i të ardhurave		229,623,051	182,263,960
Materialet e konsumuara	15	(1,317,571)	(1,459,177)
Kosto e punës			
-pagat e personelit	16	(89,463,095)	(94,872,516)
-shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	16	(10,056,252)	(9,565,578)
Amortizimet	8,9	(4,237,344)	(3,966,521)
Shpenzime të tjera	17	(97,043,011)	(94,076,858)
Totali i shpenzimeve		(202,117,273)	(203,940,650)
Fitimi nga veprimtaria kryesore		27,505,778	(21,676,691)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit, neto	18	1,001,153	(599,015)
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		1,001,153	(599,015)
(Humbja)/ Fitimi para tatimit		28,506,931	(22,275,706)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	(3,399,743)	-
Fitimi neto i vitit financiar		25,107,188	(22,275,706)

Pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (shumat në Lekë)

	Kapitali aksioner	(Humbje)/Fitime të akumuluar	Totali
Më 31 dhjetor 2015	100	15,231,190	15,231,290
Emetim i kapitalit aksioner			
Fitimi (humbja) e vitit		15,532,654	15,532,654
Dividentët e paguar		(11,848,078)	(11,848,078)
Më 31 dhjetor 2016	100	18,915,767	18,915,867
Emetim i kapitalit aksioner			
Fitimi (humbja) e vitit		(22,275,706)	(22,275,706)
Dividentët e paguar		(11,848,078)	(11,848,078)
Më 31 dhjetor 2017	100	(15,208,017)	(15,207,917)
Emetim i kapitalit aksioner			
Fitimi (humbja) e vitit		25,107,188	25,107,188
Më 31 dhjetor 2018	100	9,899,171	9,899,271

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (shumat në Lekë)

		31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
I. Fluksi monetar nga veprimataria			
Fitimi pas tatimit		28,506,931	(22,275,706)
Rregullime për:			
Amortizimin		4,237,344	3,966,521
Humbjet nga nxjerrja jashte e perdorimit e aktiveve			-
Shpenzimet e tatim fitimit		(3,399,743)	-
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues		29,344,532	(18,309,185)
Pakësim/(rritje) në tepricën e aktiveve financiare afatshkurtra	5	(51,221,334)	10,185,946
(Rritje)/(pakësim) në tepricën e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra	6	8,119,914	(1,013,301)
Pakësim i parapagimeve të tatim -fitimit	7		
Pakësim në tepricën e detyrimeve për t'u paguar	10	16,955,265	25,967,744
Rritje/(pakësim) në grante dhe të ardhura të shtyra	11	14,104	(176,652)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		3,212,480	16,654,552
Tatim fitimi i paguar	7	-	(4,881,011)
Fluksi neto monetar nga (përdorur në) / veprimtaritë e shfrytëzimit		3,212,480	11,773,541
II. Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	8	(658,297)	(5,328,671)
Fluksi neto monetar përdorur në veprimtaritë e investimit		(658,297)	(5,328,671)
III. Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit			
Dividentët e Paguar		(7,200,636)	(3,450,783)
Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e financimit		(7,200,636)	(3,450,783)
IV. Rritja/(pakësimi) neto i mjeteve monetare, neto		(4,646,452)	2,994,087
V. Mjetet monetare në fillim të periudhës	4	8,955,283	5,961,195
VI. Mjetet monetare në fund të periudhës	4	4,308,830	8,955,283

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Laureta Kellici

Administrator



PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. (referuar si "PwC Audit" ose "Shoqëria") është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 15 korrik 2009. Bazuar në dokumentat e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100 Lekë. Shoqëria është e regjistruar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT K91915023A.

Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në kryerjen e shërbimeve të auditimit dhe të konsulencës financiare dhe fiskale të cilat filluan të ofrohen nga Shoqëria në nëntor 2009.

Shoqëria ka përfaqësues ligjorë Znj. Laureta Peçi-Këlliçi.

Adresa aktuale e Shoqërisë është: Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, Godina nr.5, Zyra 1/ Kati 9.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 64 (viti 2017:56).

2 Politikat kryesore kontabël

2.1.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara në Shqipëri.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson se do të vijojë aktivitetin normal tregtar për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë këto pasqyra janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë.

2.1.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.1.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.1.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabel është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

a) Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera aktive	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Përmirësim në Qiramarrje	Mbi vlerën kontabël neto	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

b) Amortizimi i aktiveve afatgjata jo-materiale llogaritet mbi jetën e vlerësuar të aktivitetit duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Metoda dhe përqindja e amortizimit për kategorinë e aktiveve afatgjata jo-materiale paraqitet si më poshtë:

Programe kompjuterike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
-----------------------	--------------------------	-----

3.4 Zhvlerësimi

(i) Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivitetet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove perkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

4. Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente

Mjetet monetare janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari rrjedhëse		
Lekë	1,760,934	6,345,739
Euro	2,195,543	2,360,736
	3,956,477	8,706,475
Arka		
Lekë	138,967	18,646
Euro	213,378	230,162
	352,345	248,807
TOTAL	4,308,822	8,955,283

5. Aktive financiare afatshkurtra

Aktivët financiarë afatshkurtra janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë – të tretë	71,060,150	27,810,740
Klientë – palë të lidhura	18,229,994	9,917,121
Të arkëtueshme nga personeli	592,340	933,290
TOTAL	89,882,485	38,661,151

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (shumat në Lekë)

6. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime për klientët	3,790,288	5,905,990
Shpenzime të shtyra	1,801,355	4,703,054
Garanci	809,268	850,880
TOTAL	6,400,911	11,459,924

- Zëri "Shpenzime të shtyra" përfshin shpenzime që i përkasin vitit pasardhës në lidhje me sigurimet e përgjegjësisë dhe të aktiveve të Shoqërisë, pranë shoqërive të sigurimit Sigma Interbanian Viena Insurance Group dhe SIGAL sh.a., sipas policave të sigurimit dhe periudhave.

- Zëri "Garanci", përfshin garanci –parapagim për muajin e fundit të kontratës së qerasë së zyrës.

7. Parapagim tatim-fitimi

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjendja më 1 janar 2018	3,786,844	(1,094,167)
Parapagime gjatë vitit	338,842	4,881,011
Shpenzimi i tatim-fitimit	(3,399,743)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	725,943	3,786,844

8. Aktivët afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më janë përbërë si më poshtë:

Kosto historike	Permiresim në Qiramarrje	Mobilje dhe Orendi	Pajisje Informatike	Të tjera	TOTAL
Më 31 dhjetor 2016	8,103,072	6,509,357	17,964,539	4,961,709	37,538,676
Shtesa	-	248,058	4,218,653	-	4,466,711
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	8,103,072	6,757,414	22,183,192	4,961,709	42,005,387
Shtesa	-	35,443	454,374	-	489,817
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	8,103,072	6,792,858	22,637,565	4,961,709	42,495,203
Amortizimi i akumuluar					
Më 31 dhjetor 2016	(937,715)	(3,960,735)	(9,834,395)	(2,547,317)	(17,280,162)
Shtesa	(360,729)	(596,477)	(2,200,962)	(509,506)	(3,667,675)
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	(1,298,444)	(4,557,213)	(12,035,358)	(3,056,823)	(20,947,838)
Shtesa	(340,236)	(470,221)	(2,622,658)	(397,424)	(3,830,538)
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	(1,638,680)	(5,027,434)	(14,658,015)	(3,454,247)	(24,778,375)
Vlera kontabël Neto					
Më 31 dhjetor 2016	7,165,357	2,548,621	8,130,143	2,414,392	20,258,513
Më 31 dhjetor 2017	6,804,627	2,200,202	10,147,834	1,904,886	21,057,550
Më 31 dhjetor 2018	6,464,392	1,765,424	7,979,550	1,507,462	17,716,828

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në Lekë)

9. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jo-materiale përbëhen si më poshtë:

Kosto historike	Programe kompjuterike	TOTAL
Më 31 dhjetor 2016	1,486,636	1,486,636
Shtesa	861,960	861,960
Më 31 dhjetor 2017	2,348,596	2,348,596
Shtesa	168,480	168,480
Më 31 dhjetor 2018	2,517,076	2,517,076
Amortizimi i akumuluar		
Më 31 dhjetor 2015	(434,254)	(434,254)
Shtesa	(115,382)	(115,382)
Më 31 dhjetor 2016	(549,636)	(549,636)
Shtesa	(298,848)	(298,848)
Më 31 dhjetor 2017	(848,484)	(848,484)
shtesa	(406,802)	(406,802)
Më 31 dhjetor 2018	(1,255,286)	(1,255,286)
Vlera kontabël Neto		
Më 31 dhjetor 2017	1,500,112	1,500,112
Më 31 dhjetor 2018	1,261,790	1,261,790

10. Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet

Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Furnitorë palët e lidhura	55,064,562	41,471,827
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	25,686,738	18,875,390
TVSH për t'u paguar	4,377,388	1,615,344
Furnitorë	4,019,105	9,319,369
Detyrime tatimore në lidhje me personelin	2,448,721	2,452,840
Detyrime për tatime në burim	962,073	1,122,624
Furnitorë për fatura të pambërritura	546,079	1,148,797
Detyrime ndaj personelit	15,706	158,916
TOTAL	93,120,373	76,165,108

Zëri "Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura" përbëhet nga detyrimi ndaj PricewaterhouseCoopers Bulgaria për paradhënie të marra prej saj për financimin e aktivitetit në shumën 25,686,738 Lekë (31 dhjetor 2017: 18,875,390 Lekë). Më parë detyrimi ishte ndaj PricewaterhouseCoopers Bulgaria, si Shoqëri mëmë në Bullgari.

11. Grantet dhe të ardhurat e shtyra

Grantet dhe të ardhurat e shtyra me 31 dhjetor 2018 në shumën 403,655 Lekë (2017: 389,551 Lekë) përfshijnë grantet në lidhje me pajisjet informatike (routers) marrë falas nga Shoqëria dhe pajisjeve celulare të marra falas nga Telekom Albania sha., të cilat amortizohen në të ardhurat e periudhës në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas jetëgjatësisë së aktivitetit dhe në përputhje me metodën e amortizimit përkatës

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (shumat në Lekë)

12. Shitjet neto

Të ardhurat nga shitjet rezultojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shërbime konsulence	140,528,743	110,083,427
Shërbime auditimi	87,718,135	71,341,394
TOTAL	228,246,879	181,424,821

13. Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit, rezultojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura të tjera	861,879	291,016
Të ardhura të tjera nga interesi	270,782	274,679
Telefonatat personale të punonjësve	125,485	122,609
Të ardhurat e shtyra	118,026	150,835
TOTAL	1,376,172	839,139

14. Materialet e konsumuara

Materialet e konsumuara rezultojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shpenzime energji / ujë	786,111	780,603
Materiale pastrimi	273,502	266,826
Kancelari	257,958	411,748
TOTAL	1,317,571	1,459,177

15. Kosto e punës

Kostoja e punës është përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paga	89,463,095	94,872,516
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	10,056,252	9,565,578
TOTAL	99,519,347	104,438,094

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

16. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Sherbime konsulence nga te trete	31,903,611	19,124,075
Shpenzime rrjeti	19,315,495	20,096,244
Qera zyresh	9,826,880	10,314,496
Transferime, udhetime, dieta	6,261,511	15,686,291
Shpenzime postare, telekomunikacioni	4,174,334	5,749,613
Shpenzime sigurimi	4,056,154	4,562,066
Shpenzime transporti	3,735,935	2,549,531
Trajnime personeli	3,483,586	5,837,125
Mirembajtje dhe riparime	2,740,515	2,013,201
Shpenzime perfaqesimi	2,435,899	1,576,034
Shpenzime te tjera per personelin	1,825,509	1,391,313
Sherbime ligjore, noteriale, perkthimi	1,812,404	430,812
Shpenzime konsumi per zyre	945,336	982,948
Penalitet, gjoba, demshperblime	742,440	141,096
Shpenzime per sherbimet bankare	455,527	395,399
Marketing	395,533	452,894
Qera te tjera	382,865	443,301
Sponsorizime	113,053	-
Tatime te tjera	65,600	68,100
Shpenzime rekrutimi	2,665	48,197
Te tjera	2,368,160	2,214,122
TOTAL	97,043,011	94,076,858

Zëri "Shpenzime konsulence nga të tretë" përfshin shërbime konsulence nga palë të treta në lidhje me projekte të përbashkëta. Zëri "Të tjera" përfshin shpenzime shpenzime të tjera zyre, të papërfshira në zërat e tjerë.

17. Fitimet/(Humbjet) nga kursi i këmbimit, neto

Humbjet neto nga kurset e këmbimit janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fitime nga kursi i këmbimit	835,927	857,242
Humbje nga kursi i këmbimit	165,226	(1,456,257)
TOTAL	1,001,153	(599,015)

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

18. Shpenzimi i tatim-fitimit

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2018 (2013: 10%).

Deklaratat tatimore dorëzohen cdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Rakordimi i normës efektive të tatimit

	31 dhjetor 2018	%	31 dhjetor 2017	%
Fitimi/ humbja e periudhës para tatimit	28,506,931	100%	(22,275,706)	100%
Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde	4,276,040	15%	(3,341,356)	15%
Rregullime për qëllime tatimore				
Humbja fiskale	-2,188,200			
Zëra shpenzimesh të panjohura:				
Shpenzime për të tretë	17,895	0.06%	51,792	-0.23%
Shpenzime të konsumit personal	406,955	1.43%	362,092	-1.63%
Shpenzime të pajustificuara me dokumenta	333,791	1.17%	219,802	-0.99%
Shpenzime përfaqësimi	89,455	0.31%	37,812	-0.17%
Gjoha dhe penalite	111,366	0.39%	21,164	-0.10%
Të tjera shpenzime të panjohura	335,485	1.18%	460,494	-2.07%
Sponsorizime	16,958	0.06%	-	-
Tatim fitimi	3,399,743	19.6%	(2,188,201)	9.82%

19. Palë të lidhura

Në datën e bilancit, shumat e mëposhtme u korrespondojnë palëve të lidhura:

Detyrime afatshkurtra ndaj palëve të lidhura:	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
CT-Australia	-	(1,021,268)
PwC Management srl	(1,629,144)	(4,141,392)
CT-Luxembourg	(1,352,436)	(631,778)
CT-PwC Seviles BV	(17,846,472)	(9,560,728)
PL-PwC Polska Sp.z.o.o.	(4,834,893)	(3,110,846)
PricewaterhouseCoopers Bulgaria EOOD	(25,686,738)	(18,875,390)
HR-PwC d.o.o	-	(36,329)
MK-PwC Revizija doo Skopje	(262,174)	(132,983)
RO-PwC Tax Advisors & Accountant	-	(34,927)
SK-PwC CEE Firm Services sro	(6,682,841)	(4,678,978)
RU-ZAO PwC Audit	(878,730)	(653,745)
RS-PwC DOO Beograd	(1,452,027)	(8,521,095)
SK-PwC Slovensko sro	(937,088)	(539,810)
PricewaterhouseCoopers IT Services s.r.o	(6,899,433)	(6,812,692)
PwC France	-	(119,448)
PWC Consulting DOO Beograd	(55,539)	-
PWC Service Delivery Center Poland	(214,226)	(121,675)
PwC A.E (Greece)	(197,472)	(554,667)
PwC Italy	-	(518,505)
PwC Ceska Republica sro	(4,940,379)	(116,198)
PwC Estonia Tallin	(140,806)	(92,757)
PwC Germany	(5,457,233)	-
PwC Konyvviszgaló Kft	(16,664)	-
CT - United Kingdom	(488,469)	-

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë)

PwC Business Solutions B.V.	(578, 318)	-
PL-PwC Sp. Z.o.o.	(200, 210)	-
Total	(80,751,800)	(60,347,216)

Të arkëtueshme afatshkurtra nga palët e lidhura:	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
PricewaterhouseCoopers AG Switzerland	808,591	(862)
PricewaterhouseCoopers Advisor	246	1,744,304
PricewaterhouseCoopers Consult	2,736,186	4,852,675
PricewaterhouseCoopers AG	17,872	245,599
PricewaterhouseCoopers LLP	238,779	19,252
PricewaterhouseCoopers Audit		6,274
PricewaterhouseCoopers Audit s		133,500
PricewaterhouseCoopers Salzburg AG WIRT	555,390	665
PricewaterhouseCoopers Kosovo	700,156	390,581
PricewaterhouseCoopers LLP		2,023
PricewaterhouseCoopers LLP (US)	426,934	5,401
PricewaterhouseCoopers Business	-	664,750
PricewaterhouseCoopers Advisor	-	9,306
PricewaterhouseCoopers ING Germany	-	3,722
PricewaterhouseCoopers Legal	115,607	-
PricewaterhouseCoopers	583,749	69,942
PricewaterhouseCoopers LLP	-	74,927
PricewaterhouseCoopers SP zoo	78,495	222,805
PricewaterhouseCoopers LLP	192,977	183,194
PricewaterhouseCoopers LLP	-	135,462
PricewaterhouseCoopers UAB	1,688,262	
PricewaterhouseCoopers LLP Boston	-	448,678
PricewaterhouseCoopers Audit s	-	180,063
PricewaterhouseCoopers LLP	-	22,975
PricewaterhouseCoopers Ceska	-	2,260
PricewaterhouseCoopers LLP UK	593,355	438,735
PricewaterhouseCoopers Auditing	-	797
Landwell & associates	740,520	-
D&B	333,234	-
PricewaterhouseCoopers BG	8,250,925	-
PricewaterhouseCoopers Svetovanje	37,026	-
Other PwC	119,218	-
	18, 229, 994	9,526,538

20. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, PwC Audit mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekt negativ në pozicionin financiar ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria nuk ka angazhime të kontraktuara por ende të papaguara.

21. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar : Ortakeve te shoqerise tregtare "PricewaterhouseCoopers Audit " sh.p.k Tirane

Adresa : Rruga "Tbrahim Rugova", SkyTower, Godina nr.5, Zyra 1/ Kati 9. Tirane

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "PricewaterhouseCoopers Audit" sh.p.k Tirane, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale,, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2018 performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit të Përmirësuar ne Shqiperi .

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen "Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare". Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa . Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit të Përmirësuar ne Shqiperi, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë .

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Date 29/03/2019

Audituesi Ligjor
Armand Hasko



Adresa: Rr "Frosina Plaku",
21 dhjetori Tirane,
Mobile : 355682079270